



---

**Strategjia e Sigurisë e Kosovës**

**2022 - 2027**

---

## Tabela

Fjala e Kryeministrit të Republikës së Kosovës .....	3
1. Hyrje .....	4
2. Mjedisi i sigurisë.....	5
2.1 Global.....	5
2.2 Rajonal .....	6
2.3 Kërcënimet, rreziqet dhe sfidat ndaj Republikës së Kosovës .....	7
3. Interesat strategjike të Republikës së Kosovës .....	11
3.1 Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial .....	11
3.1.1 Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të fuqishëm të mbrojtjes .....	11
3.1.2 Zhvillimi i inteligjencës shtetërore.....	12
3.1.3 Zhvillimi dhe mbrojtja e infrastrukturës kritike kombëtare .....	12
3.2 Ruajtja e rendit kushtetues dhe siguria publike.....	13
3.2.1 Ngritja e kapaciteteve të Policisë së Kosovës .....	13
3.2.2 Luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar .....	14
3.2.3 Luftimi i terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm .....	14
3.2.4 Menaxhimi i emergjencave .....	14
3.3 Siguria njerëzore dhe zhvillimi shoqëror .....	15
3.3.1 Mirëqenia dhe prosperiteti i qytetarëve brenda dhe jashtë vendit.....	15
3.3.2 Qëndrueshmëria ekonomike .....	17
3.3.3 Siguria energjetike .....	17
3.3.4 Siguria mjedisore .....	18
3.3.5 Transformimi digjital .....	19
3.4 Integrimi në strukturat euro-atlantike dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë.....	19
3.4.1 Politika e jashtme .....	19
3.4.2 Anëtarësimi në NATO .....	20
3.4.3 Integrimi në Bashkimin Evropian .....	21
4. Zbatimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i SSK-së .....	23
Shtojca 1: Treguesit e ndikimit .....	25
Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial .....	25
Ruajtja e rendit kushtetues dhe siguria publike .....	26
Siguria njerëzore dhe zhvillimi shoqëror .....	27
Integrimi në strukturat euro-atlantike dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë .....	30

## Fjala e Kryeministrit të Republikës së Kosovës

Kam nderin dhe kënaqësinë që si Kryeministër i Republikës së Kosovës të paraqes Strategjinë e Sigurisë së Kosovës, vizionin strategjik dhe synimet e popullit të Kosovës dhe të institucioneve të saj, për një Kosovë të sigurt, të begatë e të qëndrueshme dhe në paqe me fqinjët e saj.

Kosova ka shënuar progres të dukshëm në konsolidimin e shtetësisë dhe demokracisë së brendshme. Ajo i ka të mëshiruara, në kulturën e popullit e të institucioneve të saj, vlerat më larta demokratike, të reflektuara në rendin kushtetues dhe në jetën e përditshme shoqërore dhe institucionale.

Strategjia e Sigurisë, e dyta me radhë që nga pavarësia e Kosovës, njeh rreziqet, kërcënimet dhe sfidat reale të sigurisë së vendit, por njëkohësisht ofron vizionin dhe synimet për ndërtimin e një shoqërie dhe shteti të sigurt e të aftë për të mbrojtur veten, dhe për të qenë partnere e besueshme për paqen dhe sigurinë rajonale dhe më gjerë.

Kosova është pjesë e familjes evropiane dhe si e tillë synon t'u ofrojë të gjithë qytetarëve të saj jetë të dinjitetshme, të lirë, të qetë dhe të begatë, ku perspektiva dhe mundësitë janë të arritshme dhe ku institucionet kujdesen dhe ofrojnë siguri, ku bashkë e ndërtojmë dhe e mbrojmë paqen e qëndrueshme.

Ne synojmë paqen me drejtësi, dhe ndërtimin e urave të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërshoqëror, ndëretnik, ndërfetar dhe ndërfqinjësor e jo ndarjen dhe mbjelljen e urrejtjes e të frikës. E ardhmja e Kosovës është e ndritur dhe e sigurt, dhe kjo po dëshmohej dita-ditës me sukseset e të rinjve e të rejave tona në të gjitha lëmit e jetës. Kjo duhet ruajtur dhe zhvilluar tutje.

Kosova mbetet e përkushtuar në ballafaqimin me sfidat aktuale në vend, por edhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me fqinjët përmes dialogut; në veçanti me Serbinë si palë e barabartë, duke u bazuar në parimet e reciprocitetit e me njohje të ndërsjellë mes shteteve.

Paqja dhe siguria në Evropë nuk mund të jenë të garantuara pa Ballkanin e integruar në familjen evropiane dhe strukturat e sigurisë. Synimi ynë strategjik për integrim në strukturat euro-atlantike nuk është i drejtuar kundër askujt, por është i drejtuar drejt së ardhmes, drejt forcimit të paqes dhe sigurisë në Republikë dhe në rajon, drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, për të mirën e shtetit, rajonit dhe të Evropës.

Rruga drejt përmbushjes së këtyre synimeve nuk do të jetë as e shkurtër e as e lehtë, por me përkushtimin tonë të vazhdueshëm, sukcesi do të arrihet dhe do të jetë i përbashkët.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës



## 1. Hyrje

Republika e Kosovës është shtet i ri, që ka trashëguar një histori të karakterizuar nga mbijetesat dhe përpjekjet për liri. Si një vend në zonën qendrore të Evropës Juglindore, i çliruar pas një lufte të ashpër dhe ndërhyrjes së mëpasshme ndërkombëtare, ka fituar pavarësinë në partneritet me aleatët e saj demokratikë.

Lufta e popullit të Kosovës për të qenë i lirë, i sigurt e për të jetuar në paqe, ka qenë një rrugëtim i dhimbshëm dhe historik, që ka përfunduar në vitin 1999. Në vitin 2008, Kosova është shpallur Republikë e pavarur dhe sovranë, duke vazhduar ta ketë vlerë larminë etno-kulturore, ku të gjithë qytetarët e saj gëzojnë të drejta dhe liri të barabarta, ndërsa si shtet demokratik nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë vendi tjetër. Këto vlera dhe parime Republika e Kosovës i ka të mishëruara në Kushtetutë dhe në ligjet e saj, sikurse dhe në dokumente të tjera shtetërore dhe sektoriale.

Republika e Kosovës që nga përfundimi i luftës dhe shpallja e pavarësisë ka ndërtuar strukturën e arkitekturës së sigurisë dhe mbrojtjes, me qëllim që t'i përgjigjet në mënyrë efektive dhe efikase nevojave të popullit për siguri. Kosova gradualisht ka marrë përgjegjësitë e saja për të adresuar, në të gjitha nivelet, sfidat, rreziqet dhe kërcënimet që i kanosen. Vendi ka shënuar një zhvillim të shpejtë të institucioneve të saja të sigurisë dhe është më i sigurt dhe më i vetë-qëndrueshëm, si dhe me synim të qartë të zhvillimit të mëtutjeshëm, fuqizimit dhe konsolidimit të sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes. Kosova ofron kontributin për sigurinë globale përmes misionëve të bashkë-zbarkimit dhe bashkëpunimit me ushtritë e vendeve aleate.

Strategjia e Sigurisë e Kosovës është dokumenti kryesor i vendit që shpalos orientimin afatgjatë të institucioneve të Republikës së Kosovës për të realizuar aspiratat e popullit të Kosovës, për të jetuar në paqe, në liri dhe në demokraci. Populli i Kosovës si dhe përfaqësuesit e tij, të zgjedhur me votën e lirë, në bashkëpunim me institucionet dhe partnerët ndërkombëtarë, do të angazhohen për të realizuar vizionin dhe qëllimet strategjike afatgjata të vendit.

### *Vizioni*

Republika e Kosovës synon të jetë vend në paqe, i lirë, i sigurt dhe i begatë, me zhvillim të qëndrueshëm, ku mbizotëron sundimi i ligjit, ruhet e mbrohet kultura, trashëgimia dhe mjedisi, duke u angazhuar në mënyrë të përshërshme për promovimin dhe kultivimin e fqinjësisë së mirë, miqësisë dhe partneritetit të qëndrueshëm me vendet e tjera, duke u bazuar në vlera euro-atlantike.

## 2. Mjedisi i sigurisë

### 2.1 Global

Mjedisi global i sigurisë karakterizohet nga paqëndrueshmëria dhe paqartësia, prandaj sfidat, rreziqet dhe kërcënimet janë komplekse dhe me ndikim në sigurinë e shteteve dhe qytetarëve.

Me qëllim rritjen e aftësive për parandalimin dhe kufizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve, si dhe për të minimizuar efektet e tyre, institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë monitorimit dhe analizës së vazhdueshme të mjedisit ndërkombëtar të sigurisë.

Sistemi demokratik i bazuar në vlera, parime, dhe rregulla të përbashkëta, kohëve të fundit, është duke u sfiduar në mënyrë serioze. Tradita euro-atlantike dhe arkitektura e saj e sigurisë politike dhe ekonomike është duke u ballafaquar me sfida, të cilat janë duke vënë në pah brishtësinë e rendit botëror. Shtetet autoritare, anembanë botës, në përpjekjet për konsolidimin dhe forcimin e pushtetit dhe projektimin e fuqisë së tyre për dominim dhe shtrirje të hegjemonisë, përbëjnë rrezik të madh për botën demokratike.

Një botë gjithnjë e më e ndërvarur dhe më e ndërlidhur ka vënë në pah nevojën që të rishikohen konceptet e sigurisë tradicionale, duke u fokusuar gjithnjë e më shumë në aspektet e sigurisë njerëzore, si pjesë e pandashme e sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare. Sfidat, me të cilat përballlet sot mjedisi global i sigurisë, si grupet kriminale trans-nacionale, grupet e dhunshme ekstremiste, ndryshimet klimatike, ndotja e mjedisit, siguria energjetike, krimi e siguria kibernetike dhe përhapja e sëmundjeve ngjitëse, nuk njohin kufij. Në veçanti, pandemia e COVID-19 ka dëshmuar që përballë sfidave dhe kërcënimeve komplekse është e domosdoshme të kemi bashkëpunim të ngushtë ndërmjet shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, ndjeshmëri e solidaritet më të lartë për zbutjen e efekteve shkatërruese si ndaj jetës së njerëzve, ashtu dhe ndaj ekonomive dhe tregjeve.

Prandaj, aspekti i sigurisë njerëzore kërkon rritjen e kapaciteteve dhe aftësive për reagim, me qëllim të parandalimit dhe menaxhimit të krizave, me fokus në ndërtimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe rritjes së resurseve institucionale në dispozicion. Përderisa ndryshimet klimatike, ruajtja e mjedisit, siguria energjetike dhe përhapja e sëmundjeve ngjitëse

përbëjnë sfidë për sigurinë globale dhe vendore, situata ndërlikohet edhe në mungesë të resurseve ose nga shfrytëzimi jo i drejtë i tyre, i kombinuar me nevojën për diversifikim.

Rishfaqja e luftërave konvencionale në kontinentin evropian, e përforcuar me elemente hibride, është bërë realitet që përbën kërcënimin më të madh për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në Evropë dhe në botë. Agresioni i paprovokuar rus ndaj Ukrainës me synim të pushtimit të një shteti sovran dhe demokratik është rreziku kryesor, me mundësi të zgjerimit dhe shtrirjes së konfliktit edhe në pjesët të tjera të Evropës. Në të njëjtën kohë, konfrontimi ndërmjet demokracive dhe autokracive me përmasa më të gjera dhe me efekte shkatërruese për rendin botëror është gjithnjë e më i mundshëm. Rusia dhe shtetet e tjera autoritare, të cilat marrëdhëniet ndërkombëtare i shohin si raporte transaksionale ndërmjet palëve, synojnë destabilizimin e botës demokratike, përmes përçarjes së aleancave perëndimore. Gërshetimi i këtyre interesave shkatërrues, i kombinuar me elementet e krimit të organizuar trans-nacional dhe terrorizmit, ngrehin shqetësime për mjedisin global të sigurisë.

## 2.2 Rajonal

Mjedisi global i sigurisë ndikon në gjendjen e gadishullit të Evropës Juglindore, ku paqartësitë lidhur me perspektivën e integritetit të vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian dhe në Organizatën e Traktatit Veri-Atlantik (NATO) përbëjnë sfidë ndaj paqes, stabilitetit dhe sigurisë në rajon. Rajoni i Ballkanit Perëndimor është i karakterizuar nga turbulencat politike, sociale dhe ekonomike. Për më tepër, kontestimet bilaterale të shtyra nga Serbia ndaj shteteve të rajonit e shumëfishojnë mundësinë për destabilizim të rajonit, të përkeqësuar ndjeshëm nga ndërhyrja e Rusisë përmes satelitëve të saj në rajon si faktor i jashtëm. Po ashtu, sfidat e tjera, sikurse mungesa e sundimit të ligjit, krimi i organizuar dhe korrupsioni, rritja e pamjaftueshme ekonomike dhe mungesa e kohezionit social, ndikojnë negativisht në gjendjen e sigurisë.

Përderisa shumica e vendeve të rajonit janë anëtarësuar apo synojnë të anëtarësohen në NATO dhe kanë qëllim të integrohen në BE, shteti serb ka zgjedhur të qëndroj qartë me Rusinë, duke kundërshtuar anëtarësimin në NATO dhe duke mos përshtatur politikën e saj të jashtme me atë të BE-së. Për më tepër, Serbia ka shtuar bashkëpunimin politik, ekonomik dhe ushtarak edhe në sferën e inteligjencës me shtetin rus. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi serbo-rus ndodh në kontekstin e përpjekjeve të vazhdueshme të Rusisë për dobësimin e rendit të vendosur nga investimi afatgjatë ndërkombëtar për paqe dhe demokratizim të vendeve të rajonit, e cila

veçanërisht vërehet në sfidat e paraqitura ndaj rendit kushtetues në Kosovë, Mal të Zi dhe Bosnjë e Hercegovinë. Lobimi i pandërprerë i Serbisë dhe përpjekjet e saj për të parandaluar Kosovën që të bëhet jetë pjesë e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale shpërfaqin qartazi qasjen bllokuese e penguese të saj ndaj rendit të vendosur në rajon.

Në anën tjetër, armatosja në rritje e Serbisë me qëllim që të marrë rolin e një hegjemoni rajonal, rrit drejtpërdrejt dilemën e sigurisë dhe mbetet burim i identifikuar i kërcënimit jo vetëm për Kosovën, por gjithashtu edhe për vendet e rajonit. Për më tepër, Serbia si nismëtare e luftërave që kanë përfshirë pothuajse të gjitha vendet e rajonit në një periudhë jo të largët kohore, nuk ka dëshmuar vullnet për të pranuar përgjegjësitë e saj nga e kaluara gjenocidale, gjë që minon përpjekjet për pajtim dhe bashkëpunim ndërmjet popujve të rajonit.

Pretendimi territorial i Serbisë ndaj Republikës së Kosovës dhe përpjekjet për të destabilizuar rendin kushtetues nëpërmjet krijimit të mekanizmave bllokues brenda dhe jashtë vendit, ndikojnë negativisht në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve. Kjo lloj qasje shton pasigurinë dhe përbën pengesë për proceset integruese. Në kuadër të dialogut me Serbinë, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, janë arritur një numër marrëveshjesh të veçanta, zbatimi i të cilave ka ngecur, për shkak të mungesës së gatishmërisë nga pala serbe. Prandaj, përfundimi i dialogut, në qendër të së cilit është njohja e ndërsjellë ndërmjet dy vendeve, përmbyll procesin e vendosjes së paqes së qëndrueshme në rajon. Republika e Kosovës do të vijojë angazhimet e saj konstruktive në përmirësimin e klimës së bashkëpunimit me fqinjët dhe me Serbinë në veçanti, bazuar në parimin e reciprocitetit.

### 2.3 Kërcënimet, rreziqet dhe sfidat ndaj Republikës së Kosovës

Paqja dhe siguria në Republikën e Kosovës cenohet nga kërcënime të jashtme dhe të brendshme. Si rrjedhojë e zhvillimeve dinamike globale, kufiri ndarës ndërmjet kërcënimeve dhe rreziqeve të jashtme dhe të brendshme është bërë pothuajse i padukshëm.

Kërcënim kryesor i sigurisë për Republikën e Kosovës është pretendimi territorial i Serbisë, cenimi i sovranitetit nga strukturat ilegale të mbështetura nga shteti serb dhe përpjekja aktive, e vazhdueshme e shtetit serb për të parandaluar avancimin dhe integrimin e Kosovës në strukturat euro-atlantike dhe në organizatat e mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Mundësia e një sulmi ushtarak konvencional ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës është i ulët, kryesisht për shkak të prezencës së forcave të udhëhequra nga NATO-ja dhe shtimit të kapaciteteve mbrojtëse të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Mjedisi global dhe rajonal i sigurisë, imponon që një kërcënim i tillë të vlerësohet në mënyrë konstante si dhe të merret në konsideratë, sepse, pavarësisht se veprimet eventuale ushtarake aktualisht frenohen, Serbia e ka bërë të qartë qëllimin e saj për mundësinë e ndërhyrjes, dhe në vazhdimësi demonstroi rritjen e mjeteve dhe kapaciteteve ushtarake.

Ndërhyrja në çështjet e brendshme të Kosovës, nga shteti serb nëpërmjet ndikimit dhe instrumentalizimit të komunitetit serb, dhe veprimtarisë së strukturave ilegale të mbështetura nga shteti serb përqendrohet kryesisht në pjesën veriore të Kosovës. Integrimi jo i plotë i kësaj pjese të popullsisë është rezultat i qëllimeve jo-miqësore të Serbisë dhe tendencave të vazhdueshme të saj që të ndikojë në prishjen e marrëdhënieve ndëretnike. Këto aktivitete kanë për synim destabilizimin, pengimin e proceseve integruese dhe zhvillimin afatgjatë të vendit.

Republika e Kosovës është e ekspozuar ndaj kërcënimeve hibride, që përfshijnë elemente jo-konvencionale, asimetrike, operacione të shtrirjes së ndikimit dhe sulme kibernetike të cilat synojnë dobësimin e sovranitetit të vendit, cenimin e integritetit dhe dëmtimin e imazhit të vendit në arenën ndërkombëtare.

Republika e Kosovës është e ekspozuar në mënyrë të vazhdueshme ndaj aktiviteteve jo-miqësore politike dhe të inteligjencës të aktorëve të huaj shtetërorë dhe jo-shtetërorë që tentojnë të cenojnë interesat kombëtare, aspiratat dhe orientimin euro-atlantik të Kosovës. Këta aktorë kërcënojnë stabilitetin e brendshëm, zhvillimin ekonomik, sektorët e mbrojtjes dhe sigurisë, duke synuar jo vetëm mbledhjen e informacionit, por gjithashtu edhe krijimin e konfuzionit nëpërmjet dezinformatave, nxitjes së përçarjeve, trazirave, si dhe konflikteve ndër-etnike.

Ndërlikimet e ndryshimeve klimatike, katastrofat e mundshme natyrore dhe njerëzore, si dhe më e rëndësishmja, përpjekjet e qëllimshme të aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë për të kompromentuar apo vënë nën kontroll infrastrukturën kritike kombëtare, janë të vazhdueshme. Për më tepër, rrezikshmëria rritet nga ndërlikimet që shkaktohen nga mungesa e infrastrukturës së avancuar, zhvillimi i pamjaftueshëm industrial si dhe jo-stabilitetit energjetik në periudhën para dhe pas luftës, të cilat sfidojnë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe të sigurisë në Kosovë. Sfidë



kritike është mungesa e ndërveprueshmërisë, koordinimit dhe komunikimit për menaxhimin e krizave emergjente ndërmjet strukturave të sektorit të rendit dhe sigurisë publike.

Qytetarët e Republikës së Kosovës, si brenda ashtu dhe jashtë vendit, janë shënjestra të mundshme për rekrutim nga organizatat ekstremiste të dhunshme me orientim politik etno-nacionalist apo religjioz. Mundësia e sulmeve terroriste në Kosovë, madje edhe shfrytëzimi i territorit në mënyrë të përkohshme për strehim ose si rrugë transiti nga individë, organizata terroriste apo resurse të tyre, do të ndikonte në stabilitetin politik dhe ekonomik të vendit.

Ngjashëm me vendet e tjera të rajonit, niveli dhe perceptimi i korrupsionit në vend, ndikon negativisht në thithjen e investimeve të huaja dhe në imazhin në arenën ndërkombëtare. Tutje ndikon drejtpërsëdrejti në zhvillimin ekonomik, shërbimet efektive dhe efikase publike dhe shtetërore, dhe në masë të madhe ka ndikim në besueshmërinë në institucionet shtetërore. Sektori i sundimit të ligjit vazhdon të përballet me sfida, edhe pse reforma të rëndësishme janë duke u ndërmarrë nga institucionet përgjatë vitit të fundit. Ndërsa prokurimi, dhënia e lejeve dhe licencave mbesin të cenueshme ndaj korrupsionit.

Mos-anëtarësimi në INTERPOL dhe organizata të ngjashme të sigurisë e detyron shtetin që të mbështetet në një mori marrëveshjesh komplekse bashkëpunimi dypalëshe. Në kohën kur organizatat kriminale trans-nacionale shfrytëzojnë teknologji të sofistikuar, kjo mungesë rezulton në vonesa dhe ndikon në efikasitetin e institucioneve të rendit që të parandalojnë aktivitetet e tilla kriminale. Po ashtu, mungesa e besueshmërisë së qytetarëve në sistemin e drejtësisë, rezultatet e mangëta gjatë dekadës së kaluar në luftën e suksesshme kundër krimit dhe korrupsionit, rrit perceptimin si dhe ndikon në mungesën e sigurisë në vend.

Reformat e ngadalshme në sistemin e drejtësisë, arsimit, zhvillimit ekonomik, shëndetësisë dhe administratë publike vazhdojnë të paraqesin sfida në përmbushjen e nevojave të tanishme dhe të ardhshme të qytetarëve, edhe pse reforma të rëndësishme janë duke u ndërmarrë nga institucionet përgjatë vitit të fundit, sidomos në fushën e sundimit të ligjit. Këto sfida kanë ndikuar që të ketë intervale të kohëpaskohshme të emigrimit të ligjshëm dhe të paligjshëm në dekadën e fundit, kryesisht drejt vendeve të zhvilluara perëndimore.

Përballja me kërcënimet, rreziqet dhe sfidat që i kanosen Republikës së Kosovës kërkojnë rritje të përpjekjeve drejt vazhdimit të identifikimit, rekrutimit, zhvillimit dhe ruajtjes së nëpunësve të sektorit publik dhe profesionistëve të tjerë që i shërbejnë shtetit dhe qytetarëve të tij me integritet,

kompetencë, profesionalizëm dhe krenari. Qëndrueshmëria, vendosmëria dhe angazhimi i çdo burri, gruaje dhe fëmije për të mos harruar kurrë koston e lirisë, përcakton kushtin që shteti dhe qytetarët e tij të adresojnë çfarëdo sfide me nder e krenari dhe në partneritet të ndërtuar mbi parimin e respektit dhe profesionalizmit.

### 3. Interesat strategjike të Republikës së Kosovës

Republika e Kosovës realizon dhe ruan interesat jetike të saj, duke respektuar parimin e lirisë, të barazisë dhe të demokracisë, duke qenë e përkushtuar për zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve si dhe duke promovuar paqe, stabilitet dhe bashkëpunim të ndërsjellë me vendet e tjera.

Interesat jetike të sigurisë janë:

- Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial;
- Ruajtja e rendit kushtetues dhe siguria publike;
- Siguria njerëzore dhe zhvillimi shoqëror;
- Integrimi në strukturat euro-atlantike dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Realizimi dhe ruajtja e këtyre interesave, bëhet nëpërmjet arritjes së objektivave strategjike, të cilat ndërlihen dhe reflektojnë në një apo më shumë interesa shtetërore.

#### 3.1 Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial

Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial nga kërcënimet e jashtme dhe të brendshme ndaj territorit të vendit është interes jetik i Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës mobilizon gjithë popullin e saj dhe shfrytëzon gjithë potencialin ushtarak, ekonomik dhe kapacitetet e tjera në mbrojtje të vendit, pavarësisht fuqisë së kundërshtarit.

Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial realizohet në koordinim dhe bashkëpunim të plotë me praninë e trupave ushtarake ndërkombëtare të udhëhequra nga NATO-ja dhe me partnerët strategjikë të Kosovës.

##### 3.1.1 Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të fuqishëm të mbrojtjes

Institucionet e sigurisë dhe të mbrojtjes fuqizohen më tutje duke rritur në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet njerëzore, teknologjike dhe sistemet e mbrojtjes.

Funksioni kryesor i Forcës së Sigurisë së Kosovës është mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës nga kërcënimet dhe rreziqet që mund t'i kanosen. Forca e Sigurisë së Kosovës zhvillon dhe mirëmban aftësitë ushtarake për mbrojtje, lëvizshmëri e manovrim dhe kapacitetet e tjera të mbështetjes luftarake me qëllim të arritjes së objektivave dhe përbushjes së misionit.

Institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes zhvillojnë dhe modernizojnë sistemin e personelit aktiv dhe rezervë, kapacitetet e inteligjencës shtetërore dhe të mbrojtjes, sistemet e armatimit dhe kapacitetet e tjera të veçanta, në përputhje me nevojat e vendit.

Institucionet Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me shtetet dhe organizatat partnere, zhvillojnë kapacitetet e nevojshme për identifikimin në kohë dhe përballjen me kërcënimet hibride të organizuara dhe të drejtuara nga shtete, organizata, grupime apo individë jomiqësor.

Republika e Kosovës synon rritjen e buxhetit në sektorin e mbrojtjes deri në 2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, ku do të rriten ndarjet buxhetore dhe investimet për të gjithë sektorët e sigurisë.

Rishikimi i strukturës organizative të sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes do të jetë i vazhdueshëm, me qëllim për t'iu përshtatur mjedisit të sigurisë dhe detyrave që dalin në funksion të realizimit dhe ruajtjes së interesave jetike shtetërore. Republika e Kosovës do të vlerësojë mundësinë për zhvillimin e modeleve të përshtatshme të forcave rezerviste si dhe atë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak sipas praktikave bashkëkohore të shteteve perëndimore në përputhje me rrethanat, kushtet dhe burimet vendore.

Republika e Kosovës angazhohet të mbështesë dhe lehtësojë zhvillimin e industrisë së mbrojtjes.

### 3.1.2 Zhvillimi i inteligjencës shtetërore

Republika e Kosovës fuqizon shërbimet e inteligjencës për të konsoliduar një sistem kompetent profesional, të besueshëm, të mbikëqyrur dhe të menaxhuar mirë. Kapacitetet njerëzore, financiare dhe teknike sikurse dhe koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional, rriten dhe zhvillohen në vazhdimësi, duke synuar cilësinë e produkteve, që mundësojnë operacionalizimin e informacionit si dhe vendimmarrje të bazuar mbi informacione dhe analiza të sakta, relevante dhe me kohë, si pjesë e një sistemi të integruar të inteligjencës. Republika e Kosovës vijon të rrisë nivelin e bashkëpunimit me partnerët strategjikë në sektorin e inteligjencës shtetërore me qëllim të mbrojtjes të interesave kombëtare.

### 3.1.3 Zhvillimi dhe mbrojtja e infrastrukturës kritike kombëtare

Republika e Kosovës, përmirëson, zhvillon dhe mbron infrastrukturën kritike kombëtare, si pjesë përbërëse e mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial. Procesi i zhvillimit të infrastrukturës kritike kombëtare, sinkronizohet në nivel shtetëror dhe me sektorin privat (industrinë), me ndërveprueshmëri të plotë si në plane zhvillimore ashtu edhe në ekzekutim dhe mbikëqyrje.

Planet zhvillimore përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat e institucioneve kombëtare për sigurinë kibernetike dhe infrastrukturën kritike, që nga koordinimi i nismave ligjore dhe strategjike deri te zhvillimi i kapaciteteve dhe funksioneve mbrojtëse të tyre. Fokusi është te zhvillimi i aftësive kolektive (publike dhe private) për ndarje të informacionit, aftësive për paralajmërim të hershëm, vetëdijes kolektive si dhe aftësive për mbrojtje të infrastrukturës kritike. Gjithashtu, prioritet është zhvillimi i politikave për krijimin e rezervave shtetërore në rast krize, me qëllim përballimin e krizave dhe zbutjen e pasojave.

Republika e Kosovës investon në fushën e sigurisë kibernetike, infrastrukturë kritike, inovacion e teknologji dhe rritje të aftësive – njëkohësisht edhe duke orientuar dhe promovuar zhvillimin në raport me prioritetet rajonale dhe sektoriale (brenda shtetit).

### 3.2 Ruajtja e rendit kushtetues dhe siguria publike

Ruajtja e rendit publik dhe kushtetues është interes jetik shtetëror që do të zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Institucionet e Republikës së Kosovës angazhohen për fuqizimin e funksionimit demokratik të institucioneve si dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore. Për të fuqizuar funksionimin e shtetit të së drejtës, zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve, synohet përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të drejtësisë dhe organeve të rendit, fuqizimi i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë si dhe reformimi i sistemit të drejtësisë dhe organeve të rendit në konsultim me shoqërinë civile dhe partnerët e saj si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe partnerët tjerë strategjikë.

#### 3.2.1 Ngritja e kapaciteteve të Policisë së Kosovës

Ministria e Punëve të Brendshme do të vazhdojë me avancimin e politikave me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe efikasitetit të Policisë së Kosovës. Me qëllim të reformimit dhe modernizimit të vazhdueshëm, Policia do të rishikojë organizimin e saj të brendshëm, për të shfrytëzuar burimet njerëzore në mënyrë sa më efektive për të kryer detyrat e rregullta, të veçanta dhe të specializuara policore. Ashtu siç parashihet në Ligjin për Policinë, do të themelohet Policia Rezervë, e cila do të mund të angazhohet për ta ndihmuar policinë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, në rrethana të jashtëzakonshme ose urgjente. Në Policinë e Kosovës do të investohet vazhdimisht në ngritjen dhe në zhvillimin e kapaciteteve, në furnizimin me pajisje të nevojshme për të kryer detyrat e saj operacionale, si dhe në kontrollimin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

### 3.2.2 Luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar

Institucionet e Republikës së Kosovës angazhohen për luftimin efikas të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përditësuar, duke avancuar dhe duke zbatuar kornizën e politikave në fushën e trafikimit me qenie njerëzore, të drogave, të armëve, të krimit kibernetik si dhe të kontrabandës të emigrantëve. Gjithashtu, do të forcohet dhe ruhet integriteti dhe besueshmëria e policisë dhe sistemit gjyqësor e prokurorial, si dhe do të arrihet komunikimi i duhur publiko-privat dhe kultivimi i kulturës së bashkëpunimit të qytetarëve me organet e rendit, për pjesëmarrje aktive të tyre në sistemin e sigurisë kombëtare. Për këtë qëllim, institucionet e sigurisë dhe të zbatimit të ligjit do të zbatojnë me përpikëri ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe do të ndërtojnë kapacitete për mbrojtjen e tyre, po ashtu do të krijohet Byro Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Ndër të tjera, Qeveria e Republikës së Kosovës do të rritë bashkëpunimin me vendet e rajonit në luftimin e krimit të organizuar ndërkufitar.

### 3.2.3 Luftimi i terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm mbeten ndër kërcënimet kryesore për sigurinë globale, rajonale dhe vendore. Përveç jetës dhe pronës së qytetarëve, ato kërcënojnë edhe vlerat demokratike dhe bazat e shoqërisë.

Republika e Kosovës do të jetë pjesë aktive në luftën globale kundër terrorizmit dhe financimit të tij, si dhe do të mbështesë rezolutën 2396 të OKB-së, si dhe partnerët dhe mekanizmat ndërkombëtarë që trajtojnë këtë fushë. Institucionet e Republikës së Kosovës bëjnë analiza të vazhdueshme të arritjeve të deritashme dhe do të vazhdojnë me programet e deradikalizimit, krahas atyre për rehabilitimin dhe ri-integrimin e luftëtarëve dhe familjeve të tyre që kthehen nga luftërat e huaja. Me qëllim të luftimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, do të hartohet Strategjia për luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm, ku do të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe format e ndërveprimit të tyre.

### 3.2.4 Menaxhimi i emergjencave

Kosova ka një ekspozim dhe cenueshmëri relativisht të lartë ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Llojet e ndryshme të katastrofave natyrore, sikurse vërshimet, thatësira, zjarret, tërmetet, temperaturat e larta dhe të tjera, si dhe prania e sasive të mëdha të materieve të rrezikshme, ndikojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi në nivelin e rrezikut dhe sigurisë për njerëzit,

pronën, kafshët, trashëgiminë kulturore dhe në mjedis. Ndryshimet klimatike kanë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e mjedisit dhe burimeve të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht edhe në sigurinë e saj. Përveç sferës mjedisore, ndryshimet klimatike mund të shkaktojnë pasoja të konsiderueshme në fushën e ekonomisë, kryesisht në bujqësi, menaxhim të ujit dhe energjisë, si dhe në ndryshime sociale të shoqëruara me rreziqe të sigurisë.

Për këtë qëllim, institucionet e Republikës së Kosovës do të zbatojnë, në mënyrë të plotë, legjislacionin në fuqi për rezervat shtetërore dhe do ta përditësojnë atë, duke siguruar pajisjet e nevojshme rezervë për rastet e emergjencave civile, në atë mënyrë që vendi të jetë në gjendje të përballojë krizat dhe gjendjet emergjente që mund t'i kanosen.

Përmes planifikimit dhe veprimeve sipas ciklit të menaxhimit emergjent, parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes, institucionet e Republikës së Kosovës do të punojnë për aftësimin e shoqërisë në atë mënyrë që ajo të jetë e qëndrueshme, për përballje me sukses me të gjitha fatkeqësitë. Në këtë drejtim, Republika e Kosovës do të fuqizojë komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit, me qëllim të përmirësimit të ndërveprueshmërisë ndërmjet të gjitha institucioneve shtetërore, sektorit privat dhe OJQ-ve, ku mes tjerash do të funksionalizohet edhe sistemi i paralajmërimit në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Ministria e Punëve të Brendshme do të ndryshojë legjislacionin aktual si dhe do të hartojë kornizën e re strategjike me qëllim të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes në rast të emergjencave. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve reaguese të AME-së, do të rritet numri i zjarrfikësve të angazhuar, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, do të themelohen dhe funksionalizohen Strukturat Shtetërore për Ndihmë dhe Shpëtim, do të hartohen programet për Funkcionet e Menaxhimit Emergjent, si dhe do të bashkërendohen aktivitetet me institucionet dhe ndërmarrjet publike për të ngritur dhe forcuar kapacitetet teknike të reagimit ndaj emergjencave.

### 3.3 Siguria njerëzore dhe zhvillimi shoqëror

#### 3.3.1 Mirëqenia dhe prosperiteti i qytetarëve brenda dhe jashtë vendit

##### *Arsimi*

Republika së Kosovës angazhohet në zhvillimin e një sistemi arsimor cilësor duke zbatuar një strategji afatgjate dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e arsimit dhe kërkimit shkencor.

Republika e Kosovës do të zbatojë një strategji që integron zhvillimin ekonomik me arsimin profesional për të nxitur inovacionin dhe aplikimin e teknologjive të reja dhe për të krijuar një forcë pune të kualifikuar.

Kosova synon zhvillimin parësor të nevojave shoqërore, emocionale, njohëse dhe fizike të një fëmije, në mënyrë që të ndërtojë një bazë të fortë dhe të gjerë për të mësuarit dhe mirëqenien gjatë gjithë jetës, si dhe krijimin e sistemit i cili ofron llogaridhënie në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit. Rishikimi i ofertës së arsimit dhe aftësimin profesional si dhe përmirësimin të cilësisë, në funksion të zhvillimit të shkathtësive të transferueshme, shkathtësive digjitale, shkathtësive të ndërmarrësisë dhe shkathtësive teknike profesionale, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me trendët e transformimit digjital dhe të gjelbër, janë proces i vazhdueshëm.

### *Shëndetësia*

Pandemia e COVID-19 ka shpërfaqur sfidat me të cilat ballafaqohet sistemi i shëndetësisë, jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë botën. Efektet e pandemisë, përveç në shëndetin e popullatës dhe sistemit të shëndetësisë, kanë shkaktuar pasoja të rënda në shoqëri dhe ekonomi, dhe ka vënë në pah se sistemi i shëndetësisë duhet trajtuar me një qasje gjithëpërfshirëse.

Resurset e mangëta financiare e infrastrukturore, kapacitetet njerëzore dhe mungesa e sistemit të paralajmërimit dhe reagimit të hershëm, shoqëruar me trendët e reja të braktisjes së vendit nga ana e profesionistëve mjekësorë, janë disa prej sfidave me të cilat shoqërohet sektori i shëndetësisë.

Prandaj institucionet e Republikës së Kosovës do të reformojnë sistemin e shëndetësisë, duke ndërtuar një qasje gjithëpërfshirëse strategjike në avancim të politikave të shëndetësisë, që përveç tjerash synojnë përmirësimin e shërbimeve profesionale mjekësore, ngritjen e kapaciteteve infrastrukturore si dhe njerëzore. Kjo do të arrihet përmes rritjes së buxhetit për shëndetësi si dhe përmes ristrukturimit dhe normalizimit të punës së Fondit për Sigurime Shëndetësore, si kushte për funksionalizimin e plotë. Paralelisht më këtë do të punohet në finalizimin e Sistemit Informativ Shëndetësor të integruar që rregullon sistemin e referimit të pacientëve në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.

Për më tepër, do të fuqizohen kapacitetet për luftimin e sëmundjeve ngjitëse, jo ngjitëse, sëmundjeve të rralla dhe emergjencave shëndetësore, si dhe do të avancohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar. Po ashtu, synohet rritëzimi i mjekëve kosovarë në diasporë si dhe ndërlidhja



me organizatat dhe odat e profesionistëve shëndetësorë, nëpërmjet programit të shkëmbimit të profesionistëve.

### *Diaspora*

Diaspora ka dhënë kontribut historik për të ndërtuar një vend të lirë, demokratik dhe paqedashës dhe tani është kontribuues kyç për zhvillimin politik, ekonomik dhe social të vendit. Po ashtu, diaspora është kontribuues dhe promovues i vlerave kulturore të Kosovës dhe ndikon në promovimin dhe përmirësimin e përfaqësimit dhe imazhit të Kosovës në botë.

Kosova, në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë, ndihmon ruajtjen e identitetit kulturor të diasporës përmes zhvillimit dhe përkrahjes së programeve të shkëmbimit profesional dhe akademik, dhe të mësimin të gjuhës. Po ashtu, duke u mbështetur në potencialin e diasporës për të ndihmuar zhvillimin socio-ekonomik të vendit, Republika e Kosovës krijon politika që promovojnë, lehtësojnë dhe stimulojnë investimet e diasporës në vend.

### 3.3.2 Qëndrueshmëria ekonomike

Republika e Kosovës zhvillon një ekonomi të qëndrueshme, duke shfrytëzuar në mënyrë efektive dhe efikase kapacitetet e saj njerëzore, financiare dhe kapitale, duke ruajtur stabilitetin ekonomik dhe duke zbatuar politika që rrisin mirëqenien e qytetarëve, që ndikon në përmirësimin e mjedisit të sigurisë.

Institucionet angazhohen seriozisht në përmirësimin e vazhdueshëm të bilancit tregtar përmes rritjes së konkurrencës ekonomike të vendit dhe krijimit të mundësive për bizneset kosovare që të rrisin eksportet e tyre. Republika e Kosovës do të mirëpresë konkurrencën me vendet me të cilat ndërton marrëdhënie të drejta dhe reciproke, ndërsa do të vendosë reciprocitet dhe masa të tjera ndaj vendeve që cenojnë bashkëpunimin në kushte barazie dhe veprojnë kundër parimeve dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare.

### 3.3.3 Siguria energjetike

Qëndrueshmëria energjetike është ndër çështjet më të rëndësishme që drejtpërdrejt lidhet me sigurinë shtetërore, zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve. Republika e Kosovës do të ndërmarrë masa për përmirësimin e menaxhimit të sektorit energjetik, për t'u përballur me ndryshimet e furnizimit me energji në tregjet rajonale e evropiane, fatkeqësitë dhe emergjencat e ndryshme, infrastrukturën e vjetruar, kërcënimet hibride dhe sulmet kibernetike.

Siguria e furnizimit me energji dhe qëndrueshmëria e sektorit arrihen nëpërmjet rritjes së prodhimit të energjisë (duke investuar në përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese dhe kapaciteteve të reja nga burimet e ripërtërishme), investimeve në infrastrukturën e energjisë (interkonektive dhe të depozitimit), avancimin e politikave dhe masave zbatuese të energjisë së ripërtërishme, efikasitetit të energjisë, si dhe integritit në tregun rajonal të energjisë, si masa të domosdoshme për tranzicionin energjetik.

Përmirësimi i politikave për burimet e ripërtërishme dhe zhvillimi i infrastrukturës që ndërlihet edhe me ruajtjen e infrastrukturës kritike të vendit, përfshirë sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë nga Liqeni i Ujmanit dhe burimeve të tjera alternative, do të ndikojë pozitivisht në zvogëlimin e rrezikut të gjenerimit të pamjaftueshëm të energjisë, duke e bërë Kosovën më pak të varur nga importi dhe një faktor të rëndësishëm në rrjedhat e energjisë në rajon.

Përmirësimi i politikave dhe zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë pritet të ketë ndikim pozitiv në uljen e kostove dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për popullatën e Republikës së Kosovës. Bashkëpunimi ndërinstitucional për paralajmërim të hershëm dhe komunikimi në kohën e duhur për kërcënimet e mundshme ndaj infrastrukturës energjetike si dhe themelimi i CERT, do të jenë prioritet, me qëllim të zvogëlimit të rrezikut.

Prandaj, duke synuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë afatgjate energjetike, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përpiluar draftin e Strategjisë së Energjisë 2022-2031, e cila vendos politika dhe masa për arritjen e civeve me kosto efektive, duke ruajtur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke synuar tranzicionin energjetik, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe Deklaratës së Sofjes.

#### 3.3.4 Siguria mjedisore

Republika e Kosovës ballafaqohet me burime të pakta ujore dhe përballet me ndotje të theksuar të mjedisit, ekosisteme të dëmtuara dhe degradim të hapësirave urbane, që përkeqësohen nga ndryshimet klimatike. Për këtë qëllim, Republika e Kosovës do të intensifikojë masat për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, nëpërmjet aplikimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse, e cila do të racionalizojë shfrytëzimin e resurseve aktuale, njëkohësisht duke synuar që të sigurohet ripërtëritja e tyre.

Në këtë drejtim, do të investohet në modernizimin e sistemeve publike të furnizimit me ujë, mbrojtjen nga ndotja, duke i dhënë përparësi investimeve në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, ndërsa fokus i veçantë do të jetë krijimi i rezervuarëve të rinj në pellgjet aktuale ujore, për të lehtësuar furnizimin me ujë gjatë thatësisë si dhe mbrojtjes nga vërshimet. Po ashtu, do të investohet në shmangien e shfrytëzimit të pakontrolluar të zhavorrit dhe rërës në shtretërit e lumenjve, dëmtimit të ekosistemeve pyjore, në ripyllëzimin e hapësirave pyjore si dhe në aplikimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbeturinave, përfshirë trajtimin e mbeturinave të rrezikshme. Për të përmirësuar cilësinë e ajrit, do të investohet më tutje në sigurimin e ngrohjes qendrore për qendrat e mëdha urbane, reduktimin e emetimit nga ndotësit industrialë si dhe nga ekonomitë shtëpiake.

### 3.3.5 Transformimi digjital

Në Kosovë ekziston potencial i nevojshëm për të mundësuar transformimin digjital si rezultat i një rinie të shkathtë dhe bizneseve me potencial që përmes shfrytëzimit të inovacionit teknologjik promovojnë zhvillim ekonomik dhe social. Transformimi digjital jetësohet me nxitjen dhe përkrahjen nga institucionet shtetërore që drejtohet nëpërmjet Agjendës Digjitale të Kosovës, e cila hartohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Për të mundësuar transformimin digjital, përpjekjet kryesore fokusohen tek promovimi dhe investimi në: njerëz, infrastrukturë, ekosistem të inovacionit, partneritete publiko-private, digjitalizim të shërbimeve, siguri kibernetike dhe inkuadrim në organizata ndërkombëtare.

## 3.4 Integrimi në strukturat euro-atlantike dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë

### 3.4.1 Politika e jashtme

Politika e jashtme dhe e sigurisë e Republikës së Kosovës reflekton interesin dhe aspiratat e popullit të Kosovës për anëtarësim në strukturat euro-atlantike, në NATO, Bashkim Evropian dhe në organizatën e Kombeve të Bashkuara, si garancia e vetme për paqe, stabilitet dhe siguri afatgjate në rajon.

Kosova intensifikon përpjekjet e saj diplomatike që ky synim strategjik të realizohet në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me shtetet aleate dhe partnere të Kosovës. Në këtë drejtim, politika e jashtme fuqizon subjektivitetin ndërkombëtar, në veçanti përmes njohjeve nga pesë vendet e Bashkimit Evropian, që ende nuk e kanë njohur Kosovën.

Vendosja dhe thellimi i marrëdhënieve dypalëshe gëzon një rol të veçantë, sikurse edhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe rajonale të sigurisë. Në thelb të marrëdhënieve dypalëshe mbetet fuqizimi dhe thellimi i marrëdhënieve dhe partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët evropianë, si dhe me fqinjët e rajonit, me theks të veçantë në zhvillimin e partneritetit strategjik me Republikën e Shqipërisë.

Kosova përafroon politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë me atë të BE-së, dhe është partnere e besueshme dhe faktor paqesje në rajon dhe më gjerë. Kosova është pjesë e koalicionit botëror në luftën kundër terrorizmit dhe qëndron përkrah vendeve aleate në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. Rritja e pjesëmarrjes në misionet ushtarake ndërkombëtare dhe pritja e organizuar e evakuimit humanitar të refugjatëve dëshmojnë seriozitetin e Kosovës në sigurinë ndërkombëtare.

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës mbështetet në parimet e drejtësisë, bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë, paqes dhe stabilitetit me vendet e rajonit dhe më gjerë. Në këtë frymë, Kosova promovon marrëdhënie të mira fqinjësore, angazhohet për thellim të marrëdhënieve strategjike dhe të partneritetit rajonal, pjesëmarrjes aktive në organizata dhe nisma rajonale që i kontribuojnë integrimit euro-atlantik të vendit.

### 3.4.2 Anëtarësimi në NATO

Republika e Kosovës ka synim të pazëvendësueshëm anëtarësimin dhe integrimin në NATO, si mekanizëm që ofron siguri strategjike afatgjate. Kjo do të bëhet nëpërmjet fuqizimit të përpjekjeve diplomatike, politike dhe ushtarake dhe sigurimit të përkrahjes nga partneri strategjik i Kosovës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet anëtare, që janë pjesë e Aleancës Veri-Atlantike. Në këtë drejtim Kosova synon që të jetë pjesë e programit të Partneritetit për Paqe dhe anëtare e Kartës së Adriatikut drejt përgatitjes për anëtarësim në NATO. Njëkohësisht, Republika e Kosovës angazhohet që të arrijë marrëveshje strategjike për bashkëpunim ushtarak në fushën e mbrojtjes me shtetet aleate.

Republika e Kosovës zbaton Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të FSK-së dhe orienton zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes në linjë me politikat e NATO-së. FSK vazhdon të ngritë dhe të zhvillojë aftësitë dhe kapacitetet luftarake për mbrojtjen e territorit, të mirëmbajë dhe të zhvillojë kapacitetet për mbështetje ushtarake për autoritetet civile, si dhe të kontribuojë në siguri përmes pjesëmarrjes në misione ushtarake jashtë vendit. FSK-ja zhvillon doktrinën, standardet dhe kapacitetet në linjë me ato të NATO-së dhe do të shtojë aktivitetet trajnuese dhe stërvitjet e

përbashkëta me vendet e NATO-së, me qëllim të aftësimit për ndërveprim me forcat e armatosura të tyre.

### *Bashkëpunimi dhe kontributi në sigurinë rajonale dhe globale*

Republika e Kosovës angazhohet për krijimin e marrëdhënieve të mira me të gjitha vendet e rajonit. Parimet kryesore me të cilat udhëhiqet Republika e Kosovës në raport me fqinjët do të jenë bashkëpunimi i ndërsjellë, barazia dhe reciprociteti. Duke u bazuar në interesat strategjike, Republika e Kosovës angazhohet në ndërtimin e bashkëpunimeve të veçanta dypalëshe dhe shumëpalëshe me ato vende dhe iniciativa me të cilat ndan vlera dhe qëllime të përbashkëta.

Institucionet shtetërore të sigurisë të Republikës së Kosovës janë të përkushtuara për pjesëmarrje aktive në organizatat ndërkombëtare, nismat rajonale dhe aktivitetet shumëpalëshe të fushës së sigurisë, me qëllim të dhënies së kontributit për stabilitetin, sigurinë dhe paqen e rajonit.

Republika e Kosovës do të vazhdojë të rritë pjesëmarrjen në operacione shumëkombëshe të mbështetjes së paqes bazuar në politikën e jashtme dhe interesat e popullit të saj. Në aspektin e emergjencave civile, institucionet relevante do të kontribuojnë në rajon me mbështetje të reagimit ndaj emergjencave civile.

### **3.4.3 Integrimi në Bashkimin Evropian**

Republika e Kosovës është historikisht, kulturalisht dhe gjeografikisht pjesë e Evropës dhe populli i saj aspiron dhe ka si qëllim madhor integrimin në Bashkimin Evropian.

Kosova avancon marrëdhëniet me BE-në nëpërmjet zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe pakos së reformave për forcimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, përmirësimin e konkurrencës ekonomike dhe klimës së investimeve, si dhe sistemit arsimor dhe punësimin. Në drejtim të avancimit të agjendës evropiane për integrim dhe anëtarësim në BE, Kosova do të aplikojë për statusin e vendit kandidat.

Kosova, pavarësisht progresit për zbatimin e kriterëve të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, mbetet vendi i vetëm në rajon që nuk gëzon lëvizjen e lirë në vendet e Bashkimit Evropian. Prandaj, Kosova do të intensifikojë fushatën e lobimit tek shtetet skeptike që të mundësohet lëvizja e lirë për qytetarët e saj.

Po ashtu, Kosova angazhohet për të qenë pjesë e nismave të përbashkëta rajonale, veçanërisht kur ato nxisin integrimin evropian të vendeve të rajonit përmes promovimit dhe kultivimit të fqinjësisë

së mirë, respektimit të parimeve dhe vlerave të lirisë, të barazisë, të njohjes dhe të respektit të ndërsjellë, si dhe të zgjidhjes së çështjeve të hapura përmes dialogut si palë e barabartë.

Kosova do të shfrytëzojë fondet e ofruara nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA III), me fokus në realizimin e prioriteteve të BE-së për rajonin, të ofruara si pjesë e iniciativës së BE-së për Planin për Ekonomi dhe Investime për Ballkanin Perëndimor. Këto fonde zbatohen në kombinim me huat e ofruara nga institucionet financiare ndërkombëtare kredibile në mënyrë që financimi i prioriteteve të vendit të bëhet në përputhje me kushtet, standardet dhe praktikat e vendeve demokratike, duke parandaluar mundësinë e ndikimit nga faktorët e mundshëm destabilizues.

#### 4. Zbatimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i SSK-së

Strategjia e Sigurisë e Kosovës është dokumenti themelor strategjik që prezanton orientimin afatgjatë të politikave dhe vizionit të Republikës së Kosovës për sektorin e sigurisë. Ky dokument përshkruan instrumentet dhe mekanizmat institucional për mbrojtjen e sovranitetit, për ruajtjen e rendit kushtetues dhe të sigurisë publike, për sigurinë shoqërore dhe njerëzore si dhe integrimin në strukturat euro-atlantike si dhe mekanizma e tjerë ndërkombëtarë, në bashkëpunim me aleatët dhe partnerët strategjikë. Strategjia është dhe do të jetë e harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe dokumentet tjera strategjike, që të krijojnë efekte sinergjike për arritjen e rezultateve të parapara.

Analiza dhe vlerësimi i SSK-së është proces dinamik dhe do të bëhet së paku çdo dy vjet, ndërsa do të përditësohet në varësi të rrethanave dhe mjedisit global, rajonal dhe vendor të sigurisë, si dhe ndryshimit të natyrës së kërcënimeve dhe rrezeve. Në këtë drejtim do të hartohet analiza e rishikimit të sektorit të sigurisë, që do të shërbejë si bazë për procesin e rishikimit të ardhshëm të sektorit të sigurisë, respektivisht të strategjisë së sigurisë.

Me qëllim të zbatimit të kësaj strategjie, institucionet e Republikës së Kosovës do të konsolidojnë strukturat shtetërore të sigurisë në një qasje integruese dhe gjithëpërfshirëse. Ndërsa, mbikëqyrja dhe vlerësimi i zbatimit do të bëhet nga Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Po ashtu, rol të veçantë në mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë do të ketë edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, që do të sigurohet për llogaridhënie. Strategjia do të zbatohet përmes strategjive sektoriale. Të gjitha institucionet relevante janë të obliguara që të prioritojnë dhe buxhetojnë politikat publike, në funksion të zbatimit të Strategjisë së Sigurisë së Kosovës.

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës do të hartojë raportin vjetor për zbatimin e Strategjisë, raport ky i cili do të përmbajë zhvillimet, ngecjet dhe sfidat e të gjitha institucioneve përgjegjëse për zbatimin e saj.

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, gjithashtu do të zhvillojë një matricë të detajuar të monitorimit të zbatimit të kësaj strategjie, në tre muajt pas miratimit. Kjo matricë do të përmbajë tregues më të hollësishëm duke u bazuar në treguesit e ndikimit që janë përfshirë në këtë Strategji. Matrica e monitorimit do të shkojë tutje duke zërthyer këta tregues ndikimi, në tregues të rezultateve dhe të produktit, në bashkëpunim me sektorët relevantë.

Si përfundim, qasja e hartimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes së SSK-së, do të mundësojë planifikim të qëndrueshëm të politikave të sigurisë, dhe Qeveria e Republikës së Kosovës do të ofrojë të gjitha resurset e nevojshme humane, financiare, dhe materiale për të përmirësuar efikasitetin e institucioneve, të menduarit analitik dhe strategjik në fushën e sigurisë, në funksion të mbështetjes së vendimmarrjes.



## Shtojca 1: Treguesit e ndikimit

### Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial

Kjo shtyllë e strategjisë do të zbatohet përmes objektivave si në vijim:

1. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të fuqishëm të mbrojtjes;
2. Zhvillimi i inteligjencës shtetërore;
3. Zhvillimi dhe mbrojtja e infrastrukturës kritike kombëtare.

Në anën tjetër, arritjen e këtyre objektivave do ta matim përmes treguesve të ndikimit si në vijim:

TREGUESI	VLERA BAZË (VITI)	MESATARJA E BALLKANIT PERËNDIMOR 6	SYNIMI (2027)	BURIMI	PËRSHKRIMI
<b>BUXHETI PËR MBROJTJE SI % E BPV IMPORTI I ARMËVE</b>	1.3% (2021)	1.5%	2%	Ministria e Mbrojtjes	Paraqet buxhetin për mbrojtje si përqindje e PVB.
<b>INDEKSI GLOBAL I SIGURISË KIBERNETIKE</b>	1/5 (2020)	1.3	1	Indeksi Global për Paqe	Vlerëson importin e armëve të një vendi.
<b>INDEKSI GLOBAL I SIGURISË KIBERNETIKE</b>	N/A Kosova tani për tani nuk është e përfshirë në këtë indeks)	64	Mesatarja e BP6	Unioni Ndërkombëtar për Telekomunikim	Vlerëson përgatitjen e vendit përmes masave ligjore, teknike, organizative dhe ato të ngritjes së kapaciteteve.
<b>SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT TË PAVËRTETË NGA QEVERITË E HUAJA</b>	Rangu 44/45 në Evropë (2020)	34/45	35/45	Varieties of Democracy	Vlerëson përfshirjen e qeverive të huaja përmes keqinformimit dhe fushatave si dhe përpjekjet e vendit për t'i kundërshtuar.
<b>FUSHATAT E QEVERIVE TË HUAJA</b>	Rangu 42/45 në Evropë (2020)	31/45	32/45	Varieties of Democracy	Vlerëson përfshirjen e qeverive të huaja përmes keqinformimit dhe fushatave si dhe përpjekjet e vendit për t'i kundërshtuar.

Siç është cekur edhe më lartë, zbatimi i SSK-së do të bëhet përmes strategjive sektoriale. Për këtë shtyllë, rëndësi të veçantë do të ketë sidomos Strategjia e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës si dhe Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike.

### Ruajtja e rendit kushtetues dhe siguria publike

Sa i përket këtij interesi të sigurisë, ai do të sigurohet përmes arritjes së objektivave si në vijim:

1. Ngritja e kapaciteteve të Policisë së Kosovës;
2. Luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar;
3. Luftimi i terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm; dhe
4. Menaxhimi i emergjencave.

Progresin në arritjen e këtyre objektivave do ta matim përmes treguesve si në vijim:

TREGUESI	VLERA BAZË (VITI)	MESATARJA E BALLKANIT PERËNDIMO		SYNIMI (2027)	BURIMI	PËRSHKRIMI
		R 6				
<b>SIGURIA (VLERËSOHET NGA 1 DERI 5, VLERA MË E ULËT MË MIRË)</b>	2 nga 5 (2020)	1.9		< 2	Indeksi Global për Paqe	Vlerëson sigurinë e vendit duke u fokusuar në nivelin e krimit, aktivitetet terroriste, demonstrata e dhunshme, marrëdhëniet me vendet fqinje, skena politike si dhe refugjatët.
<b>SUNDIMI I LIGJIT</b>	5.5 nga 10 (2021)	5.9		> 6	Bertelsmann Stiftung	Paraqet vlerësimin se ku gjendet Kosova në sundimin e Ligjit, duke u bazuar në pavarësinë e drejtësisë, ndjekjes dhe të drejtave të njeriut.
<b>INDEKSI PËR KRIM TË ORGANIZUAR</b>	5.19 nga 10 (2020)	5.88		6/10	Indeksi për Krim të Organizuar	Analizon gjendjen me trafikim të qenieve njerëzore, trafikimi me drogë, trafikimi me armë, flora dhe fauna, si dhe përpjekjet e qeverisë.
<b>PERCEPTIMI PËR KORRUPSION</b>	39/100 (2022)	38		45	Transparency International	Ky indeks agregon të dhëna nga një numër burimesh që ofrojnë perceptime të

<b>KONTROLLIMI I KORRUPSIONIT</b>	percentila 48 (nga 100) (2020)	38	55	Treguesit e Qeverisjes nga Banka Botërore	bizneseve dhe ekspertëve për nivelin e korrupsionit në sektorin publik. Përbëhet nga perceptimet se deri në ç ‘masë pushteti publik përdoret për përfitim personal, si dhe kapja e shtetit nga elitat dhe interesat private.
<b>INDEKSI GLOBAL PËR TERRORIZËM</b>	0.29/9 (2022)	0.09	0	Indeksi Global për Terrorizëm	Vlerëson incidentet, fatalitetet, lëndimet dhe dëmet pronësore nga aktiviteti terrorist.
<b>GATISHMËRIA PËR REAGIM</b>	174 nga 360 (2020)	N/A	140/360	Njësia Globale për Reduktim të Fatkeqësive dhe Rikuperim Global	Vlerëson gatishmërinë e një vendi për t'u përballë me gjendje emergjente duke analizuar kornizën ligjore, institucionale, informative si dhe pajisjet dhe personelin.

Arritja e caqeve në këtë fushë do të bëhet përmes një numri strategjish sektoriale, sidomos nga ato në vijim: Strategjia për Sundimin e Ligjit, Strategjia kundër Krimin të Organizuar, Strategjia kundër Korrupsionit, Strategjia kundër Terrorizmit, Strategjia kundër Trafikimit të Narkotikëve si dhe Strategjia për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë.

### Siguria njerëzore dhe zhvillimi shoqëror

Siguria njerëzore dhe zhvillimi shoqëror do të përmirësohet përmes arritjes së objektivave si në vijim:

1. Mirëqenia dhe prosperiteti i qytetarëve brenda dhe jashtë vendit;
2. Qëndrueshmëria ekonomike;
3. Siguria energjetike;
4. Siguria mjedisore;
5. Transformimi digjital.

TREGUESI	MESATARJA E BALLKANIT PERËNDIMO R 6			SYNIMI (2027)	BURIMI	PËRSHKRIMI
	VLERA BAZË (VITI)					
<b>EKSPORTET E MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE (% E PBB-SË)</b>	21.60% (2020)	40.20%	35.00%	Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës	Treguesi përfaqëson vlerën e të gjitha mallrave dhe shërbimeve që eksportohen në raport me PBB-në. Ky tregues paraqet pozicionin konkurrues të vendit. Eksportet përfshijnë vlerën e mallrave, ngarkesave, sigurimit, transportit, udhëtimit, honorarët, tarifat e licencës dhe shërbime të tjera, si komunikimi, ndërtimi, shërbimet financiare, informacioni, biznesi, personale dhe qeveritare.	
<b>INTENSITETI I EMETIMIT TË GAZRAVE SERË - GHG (CO2E KG/PBB-SË)</b>	1.36 kg/EUR (2020)	N/A	1.00 kg/EUR (2020)	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës	Treguesi ilustron sasinë e emetimeve të GHG të gjeneruara për njësi të PBB-së. Gazrat serë (GHG) janë një grup substancash që kontribuojnë në ngrohjen globale. Ato përfshijnë dyoksidin e karbonit (CO2), metanin (CH4), oksidin e azotit (N2O), heksafluoridin e sulfurit (SF6), perfluorokarbonet (PFCs) hidrofluorokarburet (HFCs) dhe shumë komponime të tjera.	
<b>REZULTATET NË PISA</b>	Leximi: 353.1; Matematika: 365.9; Shkenca: 364.9 (2018)	Leximi: 402; Matematika: 414; Shkenca: 408	Rritje 5% për Lexim, Matematikë dhe Shkencë	OECD	Rezultatet në testimin PISA, të OECD në lexim, matematikë dhe shkencë. Përmbajtja: kuptimi themelor i materialit; Progresi: mendime më komplekse, siç janë interpretimi dhe analiza; Konteksti: aplikimi i njohurive në situata të jetës reale.	
<b>SHKALLA E PUNËSIMIT</b>	Total: 29.3%; Gratë: 15.9%; Rinia: 12% (TM1 2021)	45.40%	54%	Agjencia e Statistikave të Kosovës	Raporti i punësimit ndaj popullsisë, i njohur edhe si shkalla e punësimit, është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që është e punësuar.	
<b>INDEKSI I JETËGJATËSISË NË HDI</b>	73 (2019)	77	75	Ministria e Shëndetësisë	Numri i viteve që do të jetonte një foshnjë e porsalindur nëse modelet mbizotëruese të vdekshmërisë në kohën e lindjes së tij	

					do të qëndronin të njëjta gjatë gjithë jetës së tij.
<b>SHKALLA E POPULLSISË QË RAPORTON FORMË TË MUNGESËS MATERIALE</b>	44.1% (2019)		20.0%	Agjencia e Statistikave të Kosovës	Përqindja e anëtarëve të familjes që jetojnë në ekonomi familjare të privuara nga tre prej nëntë dimensioneve: Nuk mund të përballojnë: 1) të paguajnë qiranë apo faturat komunale, 2) ta mbajnë shtëpinë mjaftueshëm të ngrohtë, 3) të përballojnë shpenzime të papritura, 4) të hanë mish, peshk ose ekuivalent të proteinës çdo të dytën ditë, 5) pushime një-javore larg shtëpisë për të gjithë anëtarët e familjes, 6) makinë, 7) makinë rrobalarëse, 8) TV dhe, 9) telefon.
<b>INDEKSI MESATAR I KOHËZGJATJES SË NDËRPRERJES SË SISTEMIT (SAIDI) TË ENERJISË</b>	80.83 ose 62 min/vit (2021)	N/A	<50 min/vit	Ministria e Ekonomisë	Treguesi paraqet kohëzgjatjen mesatare të ndërprerjeve për konsumator gjatë vitit. Është raporti i kohëzgjatjes vjetore të ndërprerjeve (të qëndrueshme) me numrin e konsumatorëve.
<b>PËRQINDJA E ENERJISË NGA BURIME TË RIPËRTËRISHME NË KONSUMIN TOTAL TË ENERJISË</b>	25.69% (2021)	26%	35%	Komuniteti i Energjisë dhe EUROSTAT	Paraqet përqindjen e energjisë nga burimet e energjisë së ripërtërishme, nga totali i përgjithshëm i konsumit të energjisë së një vendi.
<b>INDEKSI I GATISHMËRISË SË RRJETIT</b>	N/A (2022) (1-100)	45	50	Network Readiness Index	Treguesi paraqet gatishmërinë e një vendi për digjitalizim, duke filluar nga individi, qeveria dhe ekonomia.

Objektivat e kësaj fushe do të zbatohen përmes strategjive sektoriale, duke u fokusuar në ato si në vijim: Strategjia Sektoriale për Punësim dhe Mirëqenie Sociale, Plani Strategjik i Arsimit në Republikën e Kosovës, Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë, Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve dhe Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multi-modal.

## Integrimi në strukturat euro-atlantike dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë

Ky interes vital i sigurisë, do të realizohet përmes këtyre objektivave strategjike:

1. Forcimi i politikës së jashtme;
2. Anëtarësimi në NATO;
3. Integrimi në BE.

TREGUESI	VLERA BAZË (VITI)	MESATARJA E BALLKANIT PERËNDIMOR 6	SYNIMI	BURIMI	PËRSHKRIMI
<b>RAPORTET ME VENDET FQINJE</b>	3/5	N/A	2/5	Indeksi Global i Paqes	Treguesi vlerëson përpjekjet e vendit për fqinjësi të mirë. Gjithashtu, ai vlerëson edhe qasjen e vendeve fqinje.
<b>NUMRI I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE QË KOSOVA ËSHTË PJESË E TYRE ANËTARËSIMI NË NATO</b>	Organizata ndërkombëtare: 16 Organizma gjysmë të pavarur ndërkombëtar: 14	N/A	>25	MPJD	Treguesi paraqet numrin e organizatave ndërkombëtare ku Kosova është anëtare.
<b>ANËTARËSIMI NË NATO</b>	Përgatitjet për Anëtarësim (2022)	Të gjitha, me përjashtim të Serbisë dhe BeH	Anëtare e NATO-së	Qeveria e Kosovës	Treguesi paraqet gjendjen momentale dhe të synuar për procesin e anëtarësimit në NATO.
<b>ANËTARËSIMI NË BE</b>	Përgatitjet për aplikim për Anëtarësim (2022)	Të gjitha vendet e rajonit gëzojnë statusin e vendit kandidat	Vend Kandidat	Qeveria e Kosovës	Treguesi paraqet gjendjen momentale dhe të synuar për procesin e anëtarësimit në BE.

Zbatimi i këtyre objektivave do të bëhet përmes strategjive si Strategjia e Punëve të Jashtme, dhe përmes planeve përkatëse për anëtarësim në NATO dhe integrim në BE.